

HAMIT KABA

**KONFLIKTI SHQIPTARO-SOVJETIK
DHE SOVJETO-JUGOSLLAV
NË SYTË E PERËNDIMIT**

Konfliktet e Jugosllavisë dhe Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, përkatësisht në 1948 dhe 1960-61, ishin dy nga ngjarjet më të rëndësishme të periudhës së Luftës së Ftohtë. Ato shënuan përçarje në bllokun e vendeve komuniste të Evropës Lindore dhe përgjithësisht në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Por ato u perceptuan dhe shfrytëzuan në mënyra të ndryshme nga bota perëndimore dhe sidomos nga SHBA, si vendi më i fuqishëm i botës demokratike. Përmes këtij prezantimi të shkurtër, duke u mbështetur kryesisht në dokumentet e arkivave amerikane, gazetës *New York Times* dhe disa botimeve të autorëve të shquar amerikanë, unë do të mundohem t'u jap përgjigje disa pyetjeve që jo rrallë i kemi ndeshur dhe vazhdojnë ende të jenë prezentë në mjediset shqiptare. Të tilla pyetje lidhen me probleme të tilla, si: Si e perceptuan SHBA dhe bota perëndimore në përgjithësi konfliktin shqiptaro-sovjetik, duke e krahasuar me thyerjen sovjeto-jugosllave? Çfarë kishin të ndryshme dhe të përbashkëta këto dy shkëputje? Pse SHBA nuk ju përgjigjën sinjalit të qeverisë komuniste të Shqipërisë për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me të? Pse SHBA e konsideruan Shqipërinë vetëm si faktor përçarës brenda lëvizjes komuniste botërore dhe nuk u angazhuan direkt në përkrahje të saj, siç vepruan me Jugosllavinë? Ç'qëndrim mbajtën SHBA ndaj politikave të fqinjëve të Shqipërisë në situatën e re të krijuar nga konflikti shqiptaro-sovjetik? etj.

Për sytë e Perëndimit divorci i Shqipërisë me BRSS dhe bllokun komunist të vendeve të Evropës Lindore u perceptua ndryshe nga ai i Jugosllavisë, për arsye se në Shqipëri qeveriste një regjim dogmatik stalinist, armiqësor ndaj botës demokratike perëndimore dhe veçanërisht ndaj SHBA, me mundësi shumë të pakta ndryshimi; Në krye të PPSH ishte Enver Hoxha, një komunist stalinist ortodoks, me formim ideologjik

dhe doktrinar të një personi të pandreqshëm; Shqipëria u bë aleatja kryesore e Kinës, e cila për periudhën që po flasim ndiqte një politikë komuniste ekstreme kundër botës perëndimore në përgjithësi dhe SHBA në veçanti, si dhe kundër regjimit të Titos; Regjimi komunist i Shqipërisë ishte kundër politikave liberalizuese të ndërmarra nga Hrushovi në Kongresin e 20 të PKBS, e cila në thelb “nuk e linte mënjane epërsinë sovjetike, por përpiquej dhe shpresonte ta vendoste atë mbi baza të reja të qëndrueshme”. Kjo politikë ishte më e preferuar për perëndimin se sa ajo e Stalinit. Hrushovi po shkallmonte “stalinizmin, që ishte më tepër një formë e ndërgjegjes, se sa një forcë aktuale, i cili kishte mbetur mbrapa realiteteve të reja, dhe ishte bërë pengesë për të arritur objektivat e brendshme dhe të jashtme sovjetike”⁵⁹⁵. Ekzistencën de jure të Shqipërisë deri në vitin 1968, në strukturat e Traktatit të Varshavës dhe të Këshillit Ekonomik të Ndhmës Reciproke; Konflikti i Shqipërisë me BRSS konsiderohej si derivat i konfliktit sovjeto-kinez në mënyrën e shfaqjes, por produkt bazik dhe i qëndrueshëm në kundërshtitë e tij me BRSS. Si në vitin 1948, ashtu edhe në vitin 1960, udhëheqja shqiptare ndryshe nga Jugosllavia e Titos shfrytëzoi për t’u ripozicionuar dy çarje të mëdha brenda bllokut komunist.

Si rezultojn nga dokumentet amerikane të publikuara dhe të papublikuara⁵⁹⁶, SHBA u treguan shumë të matura në përcaktimin e politikave ndaj Shqipërisë, ashtu si kishin vepruar edhe ndaj Titos në vitin 1948, duke ruajtur ndaj tyre dyshime të forta. Por në rastin e Shqipërisë, politika amerikane nuk e mori në mbrojtje direkte Shqipërinë, duke e konsideruar atë faktor përçarës brenda botës komuniste me mundësi përfitimi prej tij. Kjo politikë u formësua në proces, ku rol të veçantë si rezultojn nga dokumentet amerikane ka luajtur Zhorzh Kennon, ideatori i politikës së “Frenimit”, i cili u emërua ambasador në Jugosllavi gjatë periudhës së konfliktit shqiptaro-sovjetik. Kjo politikë u zyrtarizua në shkurt 1963, kur Departamenti i Shtetit në konsultim me agjencitë e tjera të interesuar përgatiti një broshurë të veçantë kushtuar “politikës dhe

⁵⁹⁵ Zbigniew K. Brzezinski, *The Soviet Bloc Unity and Conflict* (Revised and Enlarged Edition), Harvard University Press. Cambridge, Massachusetts, 1967, p.181-182.

⁵⁹⁶ Foreign Relations of United States of America (FRUS); *National Archives and Record Administration* (më tej: NARA).

operacioneve” në Shqipëri⁵⁹⁷. Shqipëria, sipas këtij dokumenti konsiderohej si vendi i dytë evropian që po çlirohej nga dominimi sovjetik, kundërshtimet ndaj të cilit do të intensifikonin konfliktin kinosovjetik dhe do të ndikonin në policentrizmin dhe copëzimin e botës komuniste.

Thyerja shqiptaro-sovjetike zgjoi shpresat e armiqve tradicionalë të Shqipërisë për të shfrytëzuar atë në favor të planeve të tyre. Në këto vite u bënë prezentë konceptet dhe kërkesat e fqinjëve tanë, si: të Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë, të cilat ndryshonin nga njëra-tjetra. Politika amerikane edhe në këtë rast mbështeti pa hezitim ruajtjen e pavarësisë së shtetit shqiptar dhe tërësisë së tij territoriale e shprehur në mënyrë eksplicite me fjalët: “larg duart nga Shqipëria”⁵⁹⁸. Politika amerikane parashikonte si variant të mundshëm edhe pajtimin e Kinës me BS, dhe si rrjedhojë izolimin e Shqipërisë. Në këtë rast parashikohej që Shqipëria të përfitonte mbështetje të rëndësishme nga Perëndimi, me qëllim që të vazhdonte ta përdorte atë edhe më tej kundër BS. Në këtë rast parashikoheshin dy alternativa: a) ruajtja e regjimit komunist ekzistues në Shqipëri duke zbatuar modelin jugosllav, b) në rast të keqësimit të gjendjes së brendshme mund të vendosej një regjim jo komunist në vend. Konflikti shqiptaro-sovjetik zgjoi fërkimet e vjetra të shteteve fqinje për Shqipërinë, por edhe për probleme që ata kishin me njëri tjetrin. Treguesi më i qartë i kësaj situatë ishte përtëritja e polemikave jugosllave-greke rreth Maqedonisë greke, e cila sipas disa studiuesve shënoi fundin e Paktit Trepalësh Ballkanik të vitit 1953.

Titoja nga ana e vet u tregua i aftë të bënte koncesione ndaj perëndimit, duke ndryshuar realitetet e brendshme dhe të jashtme në Jugosllavi; Ndërkohë, udhëheqja shqiptare kishte si motiv kryesor të ndarjes së saj nga BS, pajtimin e këtij të fundit me Jugosllavinë dhe frikën e ndonjë puçi të organizuar nga Hrushovi për të rrëzuar Enver Hoxhën dhe për ta zëvendësuar atë me udhëheqës pro sovjetikë; Shqipëria edhe në vitin 1960 vazhdoi traditën e ankorimit pas një vendi të vetëm, në rastin konkret me Kinën e Mao Ce Dunit, e cila i garantonte asaj plotësimin e kërkesave ekonomike, por jo aq ato ushtarake. Përkundrazi, Jugosllavia e Titos pati aleat vendet perëndimore dhe në

⁵⁹⁷ NARA. Department of State “Guidelines for Policy and Operations, secret”, February 1963, pp.1-20.

⁵⁹⁸ *Po aty*, f.14.

veçanti SHBA, ndonëse ruajti tiparet thelbësore të një vendi socialist, duke rivendosur pas vdekjes së Stalinit marrëdhëniet me BS dhe vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore. Në dallim nga ndarja e Jugosllavisë, pas konfliktit shqiptaro-sovjetik, përveç BS, vendet e tjera socialiste nuk i ndërprejnë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë por i zbritën ato në nivele dytësore, ndërsa marrëdhëniet tregtare i rifilluan vetëm pak vite më pas. Hrushovi, ndonëse liberal në dukje u përpoq të ruante unitetin brenda bllokut komunist duke shfrytëzuar herë - herë në marrëdhënie me udhëheqjen shqiptare, metodat dhe retorikën që Stalini kishte përdorur kundër Jugosllavisë, në vitin 1948. Sipas studiuesit amerikan William Griffith, përpjekjet e Hrushovit u kulmuan me demarshet e tij për të zëvendësuar apo përmbysur udhëheqjen shqiptare. Udhëheqja komuniste e Shqipërisë sipas këtij studiuesi kishte mbijetuar falë disa rrethanave rastësore që u shfrytëzuan mjeshtërisht prej Enver Hoxhës, të tilla, si: ndarja sovjeto-jugosllave e viti 1948; revolucioni hungarez i vitit 1956 dhe konflikti sovjeto-kinez në vitet 1960-1961.

Pavarësisht nga diferencat, për sytë e botës perëndimore, konfliktet e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë me BS kishin edhe disa tipare të përbashkëta: Çarja e shqiptarëve me BRSS ishte konflikti i dytë i madh në bllokun komunist pas atij sovjeto-jugosllav, që së bashku me ngjarjet në Hungari dhe Poloni në vitin 1956 dhe me konfliktin sovjeto-kinez, i dhanë bllokut komunist goditje të forta nga brenda, aq sa ai pas kësaj e kishte humbur imazhin e një organizmi komunist monolit dhe unik. Ashtu si Jugosllavia e Titos, edhe Shqipëria e Enver Hoxhës ishin dy regjime të ardhur në pushtet pa angazhimin direkt të BS. Psikologjia e krijuar nga çlirimi i vendit me forcat e brendshme ishte një faktor i përdorur me sukses në kundërvëniet ndaj BS. Regjimi komunist shqiptar u përpoq të zgjeronte kontaktet me Perëndimin, por përpjekjet e tij ishin më të kufizuara se ato të Titos në vitin 1948, dhe ato kurrë nuk shkuan aq larg, sa që të mundësonin vendosjen e urave të komunikimit me SHBA, Britaninë e Madhe dhe RFGJ. Më 9 janar 1962 në “Zërin e Popullit” deklarohet: “ Ne dëshirojmë të vendosim marrëdhënie diplomatike dhe të kemi marrëdhënie të mira tregtare, kulturore dhe marrëdhënie të tjera me të gjitha vendet kapitaliste, ...veçanërisht me fqinjët tanë, mbi bazat e respektit reciprok të parimeve të njohura të bashkekzistencës

paqësore”⁵⁹⁹. Së fundi, si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi skena politike u dominua nga dy udhëheqës të dalë nga LDB, por me performanca dhe vizione të ndryshme për zhvillimin. Në dallim nga Enver Hoxha, Titoja diti të përfitojë me sukses nga resurset e perëndimit, duke ruajtur qeverisjen e një partie të vetme, por pa u angazhuar ushtarakisht në dy blloqet ushtarake më të mëdha të kohës. Tito e modifikoi qeverisjen e tij në proces, fenomen ky që nuk ndodhi me qeverisjen e Enver Hoxhën. Sidoqoftë, pavarësisht nga arnimet Jugosllavia e Titos ishte dhe mbeti një vend komunist, por që mbijetoi dhe të luajti me sukses ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit për gati 50, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Më 5 shtator 1961, në vazhden e intervistave të gjata të dhëna për *New York Times*, Hrushovi do t’i deklaronte analistit të çështjeve të jashtme, gazetarit amerikan Sulzberger: “natyrisht ne e konsiderojmë Jugosllavinë vend socialist”⁶⁰⁰. Me këtë referencë të shkurtër por shumë të rëndësishme për kohën, ju tha hapur Perëndimit një gjë e papërmendur më parë nga Hrushovi, i cili zbuloi publikisht pozitën e tij mbi një çështje ideologjike, e cila ishte dhe mbetej një çështje e rëndësishme ndërmjet Moskës dhe Pekinit dhe që e shqetësonte shumë Tiranën. Për të zemëruar më tej shqiptarët Hrushovi shtonte: “...nëse ajo (Jugosllavia, H.K.) do të sulmohej nga një shtet imperialist dhe do të kërkonte ndihmë tek ne, unë mendoj se ne nuk do ta refuzonim kërkesën dhe do ta ndihmonim atë”⁶⁰¹.

Ndërpërja e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike ashtu si edhe ato sovjetjo-jugosllave nuk ishin një akt i menjëhershëm, por një konflikt në rritje, i ruajtur në gjendje inkubacioni për një kohë të caktuar. Në kongresin e 4 të PPSH, në shkurt 1961 “shqiptarët, shkruan studiuesi amerikan Griffith, shpallën besnikërinë e tyre për Bashkimin Sovjetik (ashtu si kishte vepruar Tito menjëherë pas prishjes me të në vitin 1948), duke përsëritur në mënyrë të rregullt shumë çështje që i bashkonin me Moskën, dhe më pas duke rishpallur argumentet e familjarizuara kineze në lidhje me imperializmin, dhe veçanërisht me revizionizmin jugosllav...”⁶⁰².

⁵⁹⁹ William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, The M.I.T. PRESS, Massachusetts, 1953, f. 169.

⁶⁰⁰ *Po aty*, f.86.

⁶⁰¹ *Po aty*.

⁶⁰² Z. K. Brzezinski, *vep. e përm.*, f.414.

